



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET
ZYRA E MBROJTJES NGA RREZATIMET

Numri i faqeve: faqe
Numri i kopjeve: kopje

Tiranë, më ____ . ____ 2024

Drejtuar: Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet

Objekti: Mbi ndryshimet në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese si rezultat i ofrimit të shërbimeve online

Përgatiti: Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet

Datë: 5.03.2024 ora 09:00

Me anë të këtij materiali, ju paraqesim për diskutim dhe miratim çështjen që lidhet me procesin e derregullimit të shërbimeve të ZMR/ KMR dhe ofrimin e tyre online në platformën e-albania.

Në mbështetje të VKM-së Nr.252, datë 29.4.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve online nga institucionet shërbim ofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre “, ju informojmë se Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR) nga Qershor i vitit 2022 ka kërkuar në rrugë zyrtare që ofrimi i shërbimeve të saj të bëhet nëpërmjet sistemit e-albania, duke përshtatur aktet ligjore dhe nënligjore si dhe kërkesat për ofrimin e shërbimeve nëpërmjet sistemit elektronik e-Albania.

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit Nr. 8025, date 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", i ndryshuar, neni 6, pika 1 e këtij ligji përcakton se pranë Ministrisë së Shëndetësisë krijohet Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR), si autoriteti përgjegjës kombëtar rregullator, i cili mbikëqyr dhe siguron zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet.

Neni 6, pika 3 e ligjit nr. 8025 date 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", i ndryshuar përcakton se në varësi të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet ngrihet Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR) si njësi ekzekutive e tij.



Në zbatim të nenit 7, të ligjit nr. 8025 date 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese” i ndryshuar përcaktohet se Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet :

a) Harton rregulloret, udhëzimet dhe aktet e praktikave të mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe sigurinë bërthamore, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë personat fizikë e juridikë, dhe

d) Bën rekomandime dhe propozime për përmirësimin e legjislacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet.

Sa më sipër ZMR nuk është organ vendim marrës, dhe nuk mund të bëjë propozime për ndryshime apo përmirësim të legjislacionit, por zbaton vendimet e KMR, si njësi ekzekutive e tij.

ZMR ka përgatitur një draft të cilin e gjeni më poshtë, por nuk është përfundimtar, pasi propozimet do të diskutohen në mbledhjen e radhës së KMR-se dhe mbështetur në vendimin që do të marrë KMR, do të dërgohet nga ana jonë dhe tabela përfundimtare.

-Shërbimet që do të ofrohen nga ZMR nëpërmjet sistemit e-Albania:

- 1-Kërkesë për licencë për veprimtari me burime radioaktive, ruajtje – trajtim
- 2-Kërkesë për licencë për veprimtari me burime radioaktive, përdorim
- 3-Kërkesë për licencë për veprimtari me burime radioaktive, transport
- 4-Kërkesë për licencë për veprimtari me gjeneratorë me rreze x, përdorim
- 5-Kërkesë për licencë për veprimtari import-eksport ,burimeve radioaktive
- 6-Kërkesë për licencë për veprimtari me gjeneratorë/llampë me rreze x, Instalim/mirëmbajtje
- 7-Kërkesë licencë për veprimtari me gjeneratorë me rreze x / llampë me rreze x, import /eksport
- 8- Kërkesë për licencë për veprimtari me burime radioaktive, prodhim
- 9- Kërkese per regjistrim për përdorim grafi dentare intraorale.
- 10-Njoftim për mbyllje veprimtari me gjeneratorë me rreze x
- 11-Kërkesë për miratim import - eksport për burime radioaktive
- 12-Kërkesë për miratim import -eksport për gjeneratorë me rreze x
- 13-Kërkesë për miratim import -eksport për llampë me rreze x
- 14-Kërkesë për miratim transferimi për burime radioaktive
- 15-Kërkesë për miratim transferimi për gjeneratorë me rreze x
- 16-Kërkesë për miratim transporti/tranzit për burime radioaktive
- 17-Njoftim kryerjen import - eksport për burime radioaktive
- 18- Njoftim kryerjen import -eksport për gjeneratorë me rreze x
- 19- Njoftim kryerjen import -eksport për llampë me rreze x
- 20- Njoftim kryerjen transferimi për burime radioaktive
- 21- Njoftim kryerjen transferimi për gjeneratorë me rreze x
- 22- Njoftim kryerjen transport/tranzit për burime radioaktive
- 23-Kërkesë për Akt Miratimi për veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues



PROPOZIMET PËR NDRYSHIME NË LIDHJE ME DERREGULLIM E KËTYRE SHËRBIMEVE :

NDRYSHIMET NE LIGJE

1)Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8025 datë 9.11.1995”Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese” i ndryshuar me Ligjin nr.9973, datë 28.7.2008 dhe Ligjin nr. 26/2013.

1. Neni 2, pas gërmës “g” shtohet gërma “gj” si më poshtë:
2. “Regjistrimi- është një formë konfirmimi për pune të sigurta me pajisje rrezatuese dhe burime radiaktive me aktivitetin me rrisht të ulët dhe të mesëm”.
3. Neni 4 shtohet paragrafi i dytë :“Përfshihen nga procesi i licencimit për veprimtarinë përdorim vetëm pajisjet rrezatuese të llojit grafi dentare intraorale. Personat fizik ose juridik kanë detyrim të regjistrojnë në Zyren e Mbrojtjes nga Rrezatimet veprimtarinë për përdorim për pajisjet grafi dentare intraorale sipas formatit të regjistrimit të përcaktuar në rregulloren përkatëse.
4. Neni 7, pas gërmës “g” shtohet gërma “gj” si më poshtë:
“përcakton praktikën, pajisjet rrezatuese, burimet radioaktive për të cilat kërkohet regjistrim”.
5. Neni 8, pika 1, gërma “e” ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:
“e)Konfirmon regjistrimin e praktikave pajisjeve rrezatuese, burimeve radioaktive”.
6. Neni 8, pas pikës 2, shtohet pika 3 si më poshtë:
“Për shërbimet që ofrohen online nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR) i gjithë dokumentacioni arkivohet elektronikisht në platformat përkatëse ose sipas ligjit Ligjit Nr. 10237 datë 29.04.2010 “Për Dokumentin Elektronik”. Punonjësit të ZMR ju sigurohet akses për marrjen e raporteve, të dhënave sipas nevojës duke i shkarkuar ose printuar materialet në lidhje me kërkesat për licencë, miratim, regjistrim dhe njoftim. ZMR nuk mban inventar fizik për proceset online”.



2) Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10 469 ,datë 13.10.2011“ Për Mbrojtjen nga Rrezatimet Jojonizuese” i ndryshuar me Ligjin Nr. 27/2013.

1.Neni 6 gërma “f”, shfuqizohet.

2.Neni 7 gërma “e” ndryshohet si më poshtë: “Për shërbimet që ofrohen online nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR)ji gjithë dokumentacioni arkivohet elektronikisht në platformat përkatëse ose sipas ligjit Ligjit Nr. 10237 datë 29.04.2010 “Për Dokumentin Elektronik. Punonjësve të ZMR ju sigurohet akses për marrjen e raporteve, të dhënave sipas nevojës duke i shkarkuar ose printuar materialet në lidhje me kërkesat për akt miratim dhe dokumentacionin shoqërues të tyre. ZMR nuk mban inventar fizik për proceset online.



NDRYSHIMET NE VKM

3)Në VKM Nr.815 , datë 16.11.2016 “ Për transportin e sigurt të lëndëve radioaktive” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Togfjalëshi “aprovimi” zëvendësohet me “miratimi” në secilin rast në përmbajtje të kësaj VKM.
2. Togfjalëshi “aprovimit” zëvendësohet me “miratimit” në secilin rast në përmbajtje të kësaj VKM.
3. Neni 5 pika 3 ndryshohet si më poshtë:
“Formati dhe kriteret që përmban kërkesa për miratim transport/tranzit dhe afatet për shqyrtimin e kërkesës për miratim transport/tranzit, përcaktohen me udhëzim nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet”.
“Formati dhe kriteret që përmban miratimi i transport/tranzit dhe afati i vlefshmërisë së miratimit transport/tranzit përcaktohen me udhëzim nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet”
“Formati i njoftimit për kryerjen transport/tranzit të lëndëve radioaktive përcaktohet me udhëzim nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet”
4. Neni 5, pas pikës 6, shtohet pika 7 si më poshtë :
“Miratimi i transportit/tranzitit të lëndëve radioaktive shoqërohet me tarifë e cila përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale duke qenë objektive dhe marrë në konsideratë mbulimin e kostove administrative dhe paguhet në momentin e paraqitjes së kërkesës për miratim transport/tranzit”.
5. Neni 5, pas pikës 7, shtohet pika 8 si më poshtë :
“Në rast emergjence radiologjike, incidenti, gjetjes së burimeve të humbura, transporti i lëndëve radioaktive kryhet në mënyrë të menjëhershme duke njoftuar me email, shkresë ose telefon Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimet pa u pajisur me miratimin përkatës. Brenda 7 ditëve nga kryerja e transportit të lëndëve radioaktive, personat fizik ose juridik dërgojnë në ZMR njoftimin dhe dokumentacionin përkatës që lidhet me kryerjen e transportit, sipas kriterëve të kërkesës për miratim transporti”.
6. Neni 5, pas pikës 8, shtohet pika 9 si më poshtë:
“Personat fizik ose juridik dorëzojnë dokumentacion në rrugë shkresore në Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe përdorin formatet e kërkesave transport/tranzit të përshtatura për procesin online, gjatë periudhës tranzitore deri në ofrimin e këtij shërbimi në platformën e-albania.

Kërkesa të vecanta të cilat nuk gjenden online i dërgohen ZMR në rrugë shkresore”.



4) Në VKM Nr.158, datë 13/02/2008 “Për Import -Eksportin e Burimeve të Rrezatimeve Jonizues në Republikën e Shqipërisë” bëhen këto shtesa dhe ndryshime.

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“Burimet radioaktive, që do t’i nënshtrohen procedurave të import eksportit, si dhe pajisjet dhe sistemet, ku ato inkorporohen përcaktohen në VKM Nr. 801 datë 11.12.2019 “Për mbrojtjen e publikut dhe punëmarrësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimit jonizues, dhe sigurisë ndaj ekspozimeve mjekësore me burimet e rrezatimit jonizues”

2. Pika 2 gërma b togfjalëshi “ leje” zëvendësohet me “miratim”.

3. Pika 2 gërma b pas togfjalëshit “gjeneratore me rreze X”, shtohet “, llampë me rreze X”.

4. Pika 3 dhe pika 4 zëvendësohen përkatësisht me pikat 6 dhe 7 si më poshtë:

“6 . Vendimi nr.56, datë 24.02.2000, i Këshillit të Ministrave, shfuqizohet”.

“7. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse dhe zbatimin e këtij vendimi”.

5. Pas pikës 2 shtohet pika 3 si më poshtë:

“Formati dhe kriteret që përmban kërkesa për miratim import/eksport dhe afatet për shqyrtimin e kërkesës për miratim import/eksport, përcaktohen me udhëzim nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet. Format i njoftimit për kryerjen import/eksport të burimeve radioaktive, gjeneratorëve me rreze x/llampë me rreze x përcaktohen me udhëzim nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet”

6. Pas pikës 3 shtohet pika 4 si më poshtë:

“Miratimi i import-eksport burime radioaktive dhe gjeneratorëve me rreze x/llampë me rreze X shoqërohet me tarifë e cila përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë duke qenë objektive dhe marrë në konsideratë mbulimin e kostove administrative dhe paguhet në momentin e paraqitjes së kërkesës për miratim import-eksport”.

7. Pas pikës 4 shtohet pika 5 si më poshtë:

“Personat fizik ose juridik dorëzojnë dokumentacion në rrugë shkresore në Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe përdorin formatet e kërkesave import-eksport burime radioaktive dhe gjeneratorëve me rreze x/llampë me rreze X të përshatura për procesin online, gjatë periudhës tranzitore deri në ofrimin e këtij shërbimi në platformën e-albania.

Kërkesa të vecanta të cilat nuk gjenden online i dërgohen ZMR në rrugë shkresore”.



5) Ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.10 datë 7.1.2010 Për miratimin e rregullore “Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese” ndryshuar me VKM Nr. 762 datë 20.12.2023.

1. Togfjalëshi “aplikimi” zëvendësohet me “kërkesa” në secilin rast në përmbajtje të kësaj VKM.
2. Togfjalëshi “aplikimit” zëvendësohet me “kërkesës” në secilin rast në përmbajtje të kësaj VKM.
3. Togfjalëshi “aplikantit” “përdorues” “përdoruesin” zëvendësohet me “personi fizik ose juridik” në secilin rast në përmbajtje të kësaj VKM.
4. Pika 2 shtohet përmbajtja si më poshtë:

“Pajisja grafi dentare intraorale, përjashtohet nga licencimi për veprimtari përdorim, por regjistrohen sipas formatit të regjistrimit bashkëlidhur kësaj rregullore”.

5. Pika 3 Paragrafi 14 shtohet me përmbajtjen si më poshtë:
“ Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të licencës jo më vonë se 180 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit për kërkesat për licencë vëprimtari për prodhim lënde radioaktive, burim radioaktiv”.

6. Paragrafi i tretë i pikës 4 shfuqizohet, “ Licenca rinovohet në përfundim të afatit të vlefshmërisë së licencës. Rinovimi i licencës për subjektet fizik ose juridik realizohet duke plotësuar kriteret e parashikuara në pikën 3 të kësaj Rregulloreje. Procedura e shqyrtimit të rinovimit të licencës kryhet nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, në përputhje me parashikimet e pikës 3 të kësaj Rregulloreje. Licenca ndryshohet kur përgjatë kryerjes së veprimtarisë ndodh ndryshimi i të dhënave të përcaktuara në kriteret e licencimit. Kërkesa për ndryshim të licencës dhe njoftimi në Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimet për çdo ndryshim që parashikohet të kryhet në veprimtari ose burime paraqitet 60 ditë para ndryshimeve. Shtesat e burimeve radioaktive në licencë brenda kategorisë bëhen vetëm me ndryshimin e shtojcës për burimet duke njoftuar dhe me miratimin nga ZMR-ja dhe zëvendësohet me përmbajtjen si më poshtë :

“Personi fizik ose juridik paraqet kërkesë për licencë, kur kur ka ndryshime të dhënave të përcaktuara në kriteret e licencimit. Kërkesa për të dhënat që ndryshojnë bëhet sipas pikës 3 dhe formularëve të kërkesave për licencë bashkëlidhur kësaj VKM dhe shqyrtohet si një kërkesë e re”.

“Në rast se kërkesa për licencë ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, personi fizik ose juridik njoftohet për plotësim dokumentacioni. Afati 45 ditë për shqyrtimin e kërkesës për licencë fillon nga paraqitja e plotë e dokumentacionit”.

7. Pika 3 paragrafi 15 “Për çdo përdorues mbahet një dosje ,e cila në rastin e rinovimit plotësohet me elementet shtesë dhe kërkesat e KMR-së. Ngarkohet ZMR-ja për plotësimin dhe mirembajtjen e arkivit të dosjeve tij” shfuqizohet dhe zëvendësohet me përmbajtjen si më poshtë:



“Kërkesa për licencë dhe dokumentacioni shoqërues i saj arkivohet elektronikisht në platformën e-albania ose sipas Ligjit Nr. 10237 datë 29.04.2010 “Për Dokumentin Elektronik” për cdo subjekt fizik ose juridik.”

8. Pika 3 paragrafi 16 zëvendësohet me përmbajtjen si më poshtë:

“ Me miratimin e licencës nga KMR, licenca dërgohet elektronikisht tek personi fizik juridik përkatës sipas formatit të miratuar nga KMR. ZMR konfirmon regjistrimin e pajisjeve rrezatuese, burimeve radioaktive për të cilat kërkohet regjistrim brenda afatit 3 ditor dhe dërgon elektronikisht tek personi fizik/juridik dokumentin e konfirmimit të regjistrimit”.

9. Pas pikës 3 paragrafi 17, shtohet pika 3/1 me përmbajtje si vijon: Miratimi i transferimit “Formati e kriteret që përmban kërkesa për miratim transferimi për burime radioaktive/gjeneratorë me rreze x dhe afatet për shqyrtimin e kërkesës për miratim transferimi, përcaktohen me udhëzim nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet.

“Formati e kriteret që përmban miratimi i transferimit për burime radioaktive/gjeneratorë me rreze x dhe afati i vlefshmërisë së miratimit të transferimit përcaktohen me udhëzim nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet”

“Formati i njoftimit për kryerjen e transferimit të burimeve radioaktive/ gjeneratorëve me rreze x përcaktohet me udhëzim nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet”

10. Pika 12 shfuqizohet togfjalëshi, “për rinovim licence ose për ndryshimin e saj”.

11. Pika 13 paragrafi i 2 dhe formularët bashkëlidhur shfuqizohen.

12. Pas pikës 13 shtohet pika 14 si më poshtë:” Kërkesa për licencë për veprimtari me burime rrezatimi jonizues ka 8 formate bashkëlidhur kësaj rregullore si më poshtë” :

- Kërkesë për licencë për veprimtari import-eksport ,burimeve radioaktive;
- Kërkesë për licencë për veprimtari me gjeneratorë me rreze x, përdorim;
- Kërkesë për licencë për veprimtari me gjeneratorë me rreze x / llampë me rreze x, import /eksport.
- Kërkesë për licencë për veprimtari me burime radioaktive, ruajtje – trajtim;
- Kërkesë për licencë për veprimtari me burime radioaktive, transport
- Kërkesë për licencë për veprimtari me burime radioaktive, përdorim;
- Kërkesë për licencë për veprimtari me gjeneratorë/llampë me rreze x, Instalim/mirëmbajtje;
- Kërkesë për licencë për veprimtari me burime radioaktive, prodhim

13. Pas pikës 14 shtohet pika 15 si më poshtë:



“Bashkëlidhur kësaj rregullore janë 1 format” për mbyllje veprimtarie me burime rrezatimi jonizues gjeneratorë me rreze x” dhe 1 format “regjistrim për përdorim grafi dentare intraorale” si më poshtë”:

- Kerkese regjistrim për veprimtari përdorim grafi dentare intraorale.
- Kerkese njoftim për mbyllje veprimtari me gjeneratorë me rreze x

14. Pas pikës 15 shtohet pika 16 si më poshtë:

“Personat fizik ose juridik do të dorëzojnë dokumentacion në rrugë shkresore në Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimet për kërkesat për licencë, njoftim për mbyllje veprimtari gjeneratore me rreze x, regjistrim për përdorim grafi dentare intraorale të cilat nuk janë të pasqyruara në sistemin e-albania. Personat fizikë ose juridikë do të përdorin formatet e kërkesave për licencë, njoftim dhe regjistrim të përshtatura për procesin online, gjatë periudhës tranzitore deri në ofrimin e këtij shërbimi në platformën e-albania. Kërkesa të vecanta të cilat nuk gjenden online i dërgohen ZMR në rrugë shkresore”.



Aneksi I

KËRKESE PËR LICENSE PËR VEPRIMTARI IMPORT/EKSPORT BURIME RADIOAKTIVE

- Personi juridik/ fizik: _____
Emri, Mbiemri(përfaqësuesi ligjor) _____
Adresa _____
Tel _____
E-mail _____
Ekstrakti i regjistrimit në QKB _____

Nga sistemi..

- Të përshkruhen kategoritë e burimeve radioaktive, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me import/eksportin.

Dokumenta për tu ngarkuar në sistem sipas renditjes

1. Rregullore e brendshme mbi menaxhimin e burimeve radioaktive gjatë import/eksportit/et. Një dokument i veçantë për strukturën organizative
2. Listën e punëmarrësve të angazhur me import eksportin
3. Për ruajtjen e përkohëshme ngarkoni licencë për ruajtje dhe trajtim burimesh radioaktive, ose kontratën me një subjekt i cili zotëron një licencë të tillë
4. Dokument mbi mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit
5. Ngarko mandat pagesen me nr unik te kerkeses

Shenime ne faqe:

Burimet radioaktive nuk duhet të transferohen tek subjekte të cilat nuk disponojnë licensën përkatëse për përdorimin, ruajtjen etj.

Kerkuesi mban përgjegjësi të plotë ligjore për vërtetësinë e të dhënave.

I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format pdf me ngjyra, me siglat dhe vulat lidhese ne cdo faqe nga ana e personit juridik fizik.

Kërkesa e plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për subjektin që aplikon për licencë. Bazuar në nenin 3 të rregullores Nr. 10 datë 7.01.2010 për licencim dhe inspektim për marrjen e licencës, çdo person juridik dhe fizik aplikon jo më vonë se 90 ditë punë para parashikimit për fillimin e veprimtarisë. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të licencës jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit.

Në rast se kërkesa për licencë ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Pr. Administrative, afati për shqyrtimin e saj fillon nga plotësimi i dokumentacionit.



Shënim :

1. Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me Ligjin nr.8025, datë 09.11.1995, i ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.
2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standardeve bazë të mbrojtjes nga rrezatimet , Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.

Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për licensë

Burime radioaktive

Import-Eksport

Pika 3- Për ruajtjen e përkohëshme të burimeve radioaktive duhet të pajiseni me licensë për ruajtje dhe trajtim burimesh radioaktive, ose duhet të keni një kontratë me një subjekt i cili zotëron një licensë të tillë, ku të sqarohen detyrimet e secilës palë për pranimin ruajtjen dhe kthimin e burimit sipas nevojave.

Pika 4- Ploteso me shkrim mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit për të gjithë burimet radioaktive që importohen/eksportohen, listën e të gjithë subjekteve ku do të transferohen, lejet e import/eksportit të lëshuara nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, ose Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe çertifikatën e cilësisë të burimit radioaktiv.



KËRKESË PËR LICENSE PËR VEPRIMTARI ME GJENERATORË ME RREZE X
PËRDORIM
PER CDO PAJISJE TE BEHET KERKESE E VECANTE

- Personi juridik/ fizik: _____
Emri, Mbiemri(përfaqësuesi ligjor) _____
Adresa _____
Adresa ku kryhet veprimtaria, nqs është e ndryshme nga më sipër _____
Tel _____
E-mail _____
Ekstrakti i regjistrimit në QKB _____

Do merret nga sistemi

- Lloji i Gjeneratorit me rreze X:

Prodhuesi i pajisjes _____
Modeli i pajisjes _____
Numri i serisë i pajisjes _____
Tensioni maksimal _____
Rryma maksimale _____
Koha javore e ekspozimit _____
Ngarkesa javore _____
Numri i tubave _____
Modeli për çdo tub me rreze x _____
Numrat e serisë për çdo tub me rreze x _____

- Qëllimi i përdorimit të gjeneratorëve me rreze X _____
- Plotëso të dhënat mbi subjektin e autorizuar i cili do të kryejë shërbimet (mirëmbajtjen, instalimin) e pajisjeve me rreze x.
Emri Subjektit Nr. i licencës te subjektit te Licencuar _____
- Ploteso me shkrim informacion të dozave efektive te perllogaritura
në zonat publike _____
në zonat e kontrolluara _____
në zonat e survejuara _____
- Ploteso me shkrim informacion mbi justifikimin, optimizimin e ekspozimeve të publikut, stafit dhe pacientëve dhe kufizimin e ekspozimeve publike dhe të stafit, për përdorimin e gjeneratorëve me rreze x _____



- Ploteso të dhëna mbi personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet

Emri _____

Mbiemri _____

Dokumenta për tu ngarkuar në sistem sipas renditjes

1. Planimetrinë me të dhënat.
2. Dokument zyrtar mbi destinacionin e ambientit
3. Dokument në lidhje me mënyrën se si është përfituar gjeneratori me rreze x (Dokumenti i blerjes/dhurimit)
4. Çertifikatën e kontrollit teknik dhe testet për çdo pajisje sipas VKM nr.404 datë 18/06/2014
5. Kontratën me subjektin e autorizuar i cili do të kryejë shërbimet (mirëmbajtjen, instalimin) të pajisjeve me rreze x.
6. Një dokument veçantë strukturën organizative.
7. Listën e punëmarrësve që do të manipulojnë me burimin/et radioaktiv/e dhe pajisjen ku është inkorporuar, që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara.
8. Diplomë ose çertifikatë profesionale për çdo punëmarrës që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara.
9. Çertifikatë trajnimi për çdo punëmarrës që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara. Vërtetim testimi për çdo punëmarrës që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara
10. Kontratën me Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar për monitorimin e dozës së ekspozimit të punëmarrësve gjatë punës me gjeneratorë me rreze x sipas listës së deklaruar të punëmarrësve
11. Kontratën e punës për personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet me punëdhënësin dhe kualifikime të vecanta
12. Planin e reagimit në rast incidenti
13. Rregullore e brendshme për përdorimin e gjeneratorëve me rreze x, kode praktike etj. Dokument mbi mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit
14. Raportin e vlerësimit të sigurisë dhe mbrojtjes nga rrezatimet
15. Raportin mjekësor i aftësisë për punë me pajisje me rreze x lëshuar nga ISHP për çdo punëmarrës që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara.
16. Ngarko mandat pagesen me nr unik te kerkeses

Kerkuesi mban përgjegjësi të plotë ligjore për vërtetësinë e të dhënave.

I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format pdf me ngjyra, me siglat dhe vulat lidhese ne cdo faqe nga ana e personit juridik fizik.

Kërkesa e plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për subjektin që aplikon për licencë. Bazuar në nenin 3 të rregullores Nr. 10 datë 7.01.2010 për licencim dhe inspektim për marrjen e licencës, çdo person juridik dhe fizik fillon pregatitjen e dokumenacionit



jo më vonë se 90 ditë punë para parashikimit për fillimin e veprimtarisë. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të licencës jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit.

Në rast se kërkesa për licencë ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Pr. Administrative, afati për shqyrtimin e saj fillon nga nga plotësimi i dokumentacionit. Shënim :

1. Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me Ligjin nr.8025, datë 09.11.1995, i ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.

2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standardeve bazë të mbrojtjes nga rrezatimet, Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.

Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për licencë

Përdorim

Gjeneratorë me rreze x

Pika 1- Planimetrinë e ambienteve, vendndodhjes së panelit të kontrollit, pajisjeve mbrojtëse të lëvizshme, dyerve, dritareve, ventilatorëve, pasazheve, dhomës së errët, ambienteve të pritjes së pacientëve, qëndrimin e personelit, ambientet rreth kabinetit, materialin dhe dimensionet përkatëse. Ploteso me ngjyra zonat e kontrolluara, të survejuara dhe zonat publike.

Planimetria të Plotesohet në një format të qartë dhe të specifikuar në mënyrë të dukshme me të gjithë elementët.

Pika 2-Një dokument zyrtar, i cili përcakton destinacionin e ambjenteve ku do ushtrohet veprimtaria. (Sipas Urdhrit Nr. 415, datë 11.10.2011, i Ministrit të Shëndetësisë për ndërtimin e kabineteve të radiologjisë dhe ato me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive). Certifikate Pronësie ASHK.

Pika 4-Certifikate kontrollit teknik e vendit të origjines ose certifikate të kontrollit teknik e v;eresuar në Shqipëri, referoju faqes zyrtare, <http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/> ku përcaktohet lista e personave/subjekteve të njohur nga KMR për këtë qëllim.

Pika 5- Nje dokument veçantë strukturën organizative dhe listën e punëmarrësve që do të manipulojnë me gjeneratorin/ët me rreze x, që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara. Ploteso dokumentacionin në lidhje me kualifikimet dhe eksperiencat e stafit.

Pika 10- Kontrata me Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar,Tiranë, për monitorimin e dozës së ekspozimit të punëmarrësve gjatë punës me gjeneratorë me rreze x sipas listës së deklaruar të punëmarrësve e cila të jetë e përshtatshme për llojin dhe energjitë e rrezatimit që keni në përdorim. Për praktikën siç përcaktohen në nenin 31 të VKM nr.801 datë 11/12/2019 për të cilat nuk është e nevojshme nënshkrimi i kontratës për dozimetritë personale me IFBZ të kryhet monitorimi i vendit të punës nga përgjegjësi i mbrojtjes nga rrezatimet ose nga një ekspert i mbrojtjes nga rrezatimet. Te ngarkohet në sistem dokumenti vlerësues.



Pika 11-Diplomeiplomë/çertifikatë që vërteton kompetencën profesionale të tij/saj në lidhje me punën që do të kryejë, si dhe çertifikatë trajnimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese lëshuar nga institucionet e njohura nga KMR, të ngarkohet vërtetimi i testimit. Ritrajnimi dhe testimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet kryhet çdo pesë vjet. Për realizimin e trajnimit dhe testimit të njohurive në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, referoju faqes zyrtare, <http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/> ku përcaktohen institucionet e njohura për këtë qëllim.

Pika 13- Një dokument me shkrim për mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit për dozimetrinë personale, monitorimit të vendit të punës, incidenteve, trajnimit, shërbimeve të pajisjeve dhe kontrolli mjekësor periodik i punëmarrësve .

Pika 14- Vlerësimin për sigurinë(ekspertizen) dhe mbrojtjen nga rrezatimi sipas udhëzuesit miratuar nga KMR nr.72/21 datë 17/08/2021. Për realizimin e raport ekspertizës referoju faqes zyrtare, <http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/> ku përcaktohet lista e personave/institucioneve të njohur nga KMR për realizimin e raportit/ekspertizën mbi sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese. Subjektet private për kryerjen e ekspertizës ti referohen listës së ekspertëve të njohur nga KMR, ndërsa subjektet shtetërore të kontaktojnë Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, siç përcaktohet në faqen zyrtare.



KËRKESË PËR LICENSE PËR VEPRIMTARI ME GJENERATORË ME RREZE X
/ LLAMPË ME RREZE X

IMPORT/EKSPORT

- Personi juridik/ fizik: _____
Emri, Mbiemri(përfaqësuesi ligjor) _____
Adresa _____
Tel _____
E-mail _____
Ekstrakti i regjistrimit në QKB _____

Nga sistemi

- Të përshkruhen praktikat dhe llojet me gjeneratorë me rreze x / llampë me rreze x, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me import/eksportin.

Dokumenta për tu ngarkuar në sistem sipas renditjes

- Ngarko dokumenti me llojet e pajisjeve që do të importohen/eksportohen sipas funksionit (ct skaner, radiografi, grafi, panorameks, mamografi, densitometër, koronografi etj), si dhe të sqarohet nëse do importohen/eksportohen llampa me rreze x.
- Ngarko rregullore e brendshme mbi menaxhimin e import/eksportit të gjeneratorëve dhe llampave me rreze x
- Ngarko dokument mbi mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit

Kerkuesi mban përgjegjësi të plotë ligjore për vërtetësinë e të dhënave.

I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format pdf me ngjyra, me siglat dhe vulat lidhese ne cdo faqe nga ana e personit juridik fizik.

Kërkesa e plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për subjektin që aplikon për licencë. Bazuar në nenin 3 të rregullores Nr. 10 datë 7.01.2010 për licencim dhe inspektim për marrjen e licencës, çdo person juridik dhe fizik fillon përgatitjet për kërkesën jo më vonë se 90 ditë punë para parashikimit për fillimin e veprimtarisë. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të licencës jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit.

Në rast se kërkesa për licencë ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Pr. Administrative, afati për shqyrtimin e saj fillon nga plotësimi i dokumentacionit.

Shënim :

1.Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me Ligjin nr.8025, datë 09.11.1995, i ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.



2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standardeve bazë të mbrojtjes nga rrezatimet , Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.

Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për licensë

Gjeneratorë/llampë me rreze x

Import/eksport

Pika 2-Një rregullore e brendshme e subjektit. Në rregullore të përcaktohet qartë që subjekti nuk transferon pajisje me rreze x ose llampë me rreze x në subjekte të cilat nuk disponojnë licencën përkatëse. Të përcaktohet qartë adresa e magazinimit të pajisjeve dhe llampave me rreze x të importuara.

Pika 3- Nje dokumentper mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit për të gjitha pajisjet dhe llampat me rreze x që importohen/eksportohen, listën e të gjithë subjekteve ku do të transferohen, lejet e import/eksportit të lëshuara nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet, çertifikatën e cilësisë së gjeneratorit me rreze x.



KËRKESE PËR LICENSE PËR VEPRIMTARI ME BURIME RADIOAKTIVE

RUAJTJE-TRAJTIM

- Personi juridik/ fizik: _____
Emri, Mbiemri(përfaqësuesi ligjor) _____
Adresa _____
Adresa ku kryhet veprimtaria, nqs është e ndryshme nga më sipër _____
Tel _____
E-mail _____
Ekstrakti i regjistrimit në QKB _____

Nga sistemi

- Ploteso me shkrim informacion të dozave efektive
në zonat publike _____
në zonat e kontrolluara _____
në zonat e survejuara _____
- Ploteso të dhëna mbi personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet
Emri _____
Mbiemri _____
- Ploteso të dhëna mbi personin përgjegjës për sigurimin fizik të objektit ku kryhet
veprimtaria ku përdoren burime radioaktive
Emri _____
Mbiemri _____

Dokumenta për tu ngarkuar në sistem sipas renditjes

1. Ngarko planimetrinë me të dhënat sipas sqarimit në pikën nr.1
2. Ngarko dokument zyrtar mbi destinacionin e ambientit sipas sqarimit në pikën nr.2
3. Ngarko plani i sigurimit për burimet radioaktive sipas sqarimit në pikën nr.3
4. Ngarko raportin e vlerësimit të sigurisë (ekspertiza) dhe prezantimi i safety case sipas sqarimit në pikën 4
5. Ngarko me tabelë inventarin me karakteristikat dhe të dhënat e burimeve radioaktive në ruajtje, kondicionim etj.
6. Ngarko programin e monitorimit të mjedisit
7. Ngarko rregullore e brendshme për ruajtje dhe trajtimin e burimeve radioaktive
8. Ngarko një dokument vecantë strukturën organizative
9. Ngarko listën e punëmarrësve që do të manipulojnë me burimin/et radioaktiv/e dhe pajisjen ku është inkorporuar, që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara.
10. Ngarko Diplomë ose certifikatë profesionale për çdo punëmarrës që lidhet me veprimtarinë.
11. Ngarko Certifikatë trajnimit për çdo punëmarrës që lidhet me veprimtarinë. Vërtetim testimi për çdo punëmarrës që lidhet me veprimtarinë.



12. Ngarko kontratën me Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar për monitorimin e dozës së ekspozimit të punëmarrësve gjatë punës me burimet radioaktive sipas listës së deklaruar të punëmarrësve
13. Ngarko kontratën e punës për personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet me punëdhënësin dhe kualifikime të veçanta
14. Ngarko kontratën e punës për personin përgjegjës për sigurimin fizik, me punëdhënësin dhe kualifikime të veçanta sipas sqarimit në pikën nr.7
15. Ngarko planin e përgatitjes dhe reagimit në rast incidenti, aksidenti ose event radiologjik
16. Ngarko formatin e regjistrit të shkarkimeve në mjedis
17. Ngarko formatin mbi njoftimin e humbjes, vjedhjes ose sabotimit,
18. Ngarko raportin mjekësor i aftësisë për punë me burime radioaktive lëshuar nga Instituti i Shendetit Publik për çdo punëmarrës që lidhet me veprimtarine
19. Ngarko mandat pagesen me nr unik te kerkeses

Kerkuesi mban përgjegjësi të plotë ligjore për vërtetësinë e të dhënave.

Burimet radioaktive nuk transferohen në subjekte të cilat nuk disponojnë licensën përkatëse.

I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format pdf me ngjyra, me siglat dhe vulat lidhese ne cdo faqe nga ana e personit juridik fizik.

Kërkesa e plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për subjektin që aplikon për licensë. Bazuar në nenin 3 të rregullores Nr. 10 datë 7.01.2010 për licencim dhe inspektim për marrjen e licensës, çdo person juridik dhe fizik aplikon jo më vonë se 90 ditë punë para parashikimit për fillimin e veprimtarisë. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të licensës jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit.

Në rast se kërkesa për licensë ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Pr. Administrative, afati për shqyrtimin e saj fillon nga plotesimi i dokumentacionit.

Shënim :

1.Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me Ligjin nr.8025, datë 09.11.1995, i ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.

2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standardeve bazë të mbrojtjes nga rrezatimet, Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.

Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për licensë
Burime radioaktive
Ruajtje-Trajtim



Pika 1- Planimetria të plotesoet në një format të përshtatshëm dhe të specifikojë në mënyre të dukshme të gjithë elementët, ambientet, vendndodhjen e burimit/eve radioaktiv/e, pajisjeve mbrojtëse të lëvizshme, dyerve, dritareve, ventilatorëve, pasazheve, qëndrimin e personelit, ambientet rreth kabinetit, materialin dhe dimensionet përkatëse. Ploteso me ngjyra zonat e kontrolluara, të survejuara dhe zonat publike.

Pika 2-Nje dokument per destinacionin e ambienteve. Të plotesoet një dokument zyrtar, i cili përcakton destinacionin e ambienteve ku do ushtrohet veprimtaria. (Sipas Urdhrit Nr. 415, datë 11.10.2011, i Ministrisë të Shëndetësisë për ndërtimin e kabineteve të radiologjisë dhe ato me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive). Certifikate ASHK.

Pika3-Plani i sigurimit për burimet radioaktive të kategorisë I,II dhe III sipas udhëzuesit të KMR nr.444/8 datë 29/03/2019. Të Plotesoet plani i sigurimit fizik për përdorimin e burimeve radioaktive të kategorisë I, II dhe III, i cili të jetë në përputhje me rregulloren Nr.877 datë 30.10.2015 "Mbi sigurimin fizik të materialeve radioaktive" si dhe udhëzuesin Nr.444/8 datë 29.03.2019. Për përgatitjen e këtij plani të kontaktohet personi i ngarkuar nga Policia e Shtetit në Drejtorinë vendore të policisë /komisariati i policisë ,aty ku subjekti ustron veprimtarinë për ruajtje/trajtim të burimeve radioaktive të kategorisë 1,2 dhe 3 . Referoju faqes zyrtare të internetit <http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/>.

Pika 4- Raporti i vlerësimit të sigurisë dhe prezantimi i "safety case", të përmbajë vlerësimin për sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimi në analogji me udhëzimin e miratuar nga KMR nr.72/21 datë 17/08/2021. Plani të përmbajë elementët e mëposhtëm, në përputhje me rregulloren nr.638 datë 07/09/2016 për trajtimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë.

- a) Qëllimi i ruajtjes dhe trajtimit të burimit/eve radioaktiv/e
- b) programet operative të menaxhimit të mbetjeve radioaktive,
- c) financimin për trajtimin e mbetjeve,
- d) kushtet e përgjithshme për kontrollin e prodhimit të mbetjeve,
- e) minimizimin e prodhimit të mbetjeve,
- f) ripërdorimin dhe riciklimin e burimeve që nuk përdoren më
- g) heqjen nga kontrolli rregullator
- h) Kriteret e pranimit
- i) sqarime mbi moshollimin e mbetjeve me qëllim shkarkimet në mjedis
- j) shkarkimi i mbetjeve radioaktive në mjedis
- k) karakteristikat e mbetjeve radioaktive
- l) klasifikimin e mbetjeve
- m) ndarjen e mbetjeve radioaktive
- n) trajtimi dhe kondicionimi
- o) paketimi
- p) kushtet e përgjithshme për ruajtjen e përkohëshme
- q) elemente të depos për ruajtje të përkohëshme
- r) ruajtja afatgjatë
- s) kushtet speciale në rast mospërputhje me kriteret e pranimit
- t) programi i monitorimit
- u) rishikime periodike të sigurisë, Ploteso me shkrim një informacion në lidhje me
- v) elementë të përgjithshme për cmonitimin e depos



- w) kushtet speciale në rast mospërputhje me kriteret e pranimi
- x) programi i monitorimit
- y) rishikime periodike të sigurisë
- z) elemente të përgjithshme për cmonitimin e depos

Ploteso me shkrim një dokument me informacion mbi shërbimet bazë, pajisjet që do të përdoren për ruajtjen dhe trajtimin e burimeve radioaktive. Sqaro në detaje proceset që do të kryhen dhe pajisjet që do të përdoren.

Ploteso me shkrim informacion mbi justifikimin dhe kufizimin e ekspozimeve publike dhe të stafit në procesin e ruajtjes dhe trajtimit të burimeve radioaktive

Pika 8- Subjektet që do të ruajnë /trajtojnë burime radioaktive të kategorisë 1,2 dhe 3 duhet të dërgojnë paraprakisht në ZMR ,para fillimit të plotësimit të procedurave për licensë,listën e punonjësve që do të kenë akses /infomacion mbi burimet radioaktive të kategorisë 1,2,dhe 3, me qëllim dërgimin në strukturat përkatëse për verifikimin e besueshmërisë dhe përshtatshmërinë e tyre. Informacioni duhet të përfshijë për secilin të dhënat e mëposhtme;

1.Emër/mbiomer 2.Funksioni 3.Nr.i kartes së identitetit/ose pashaportës4.Nr.Personal 5.Vendlindja 6.Vendbanimi 7.Ditëlindja 8.Shtetësia

Pas marrjes së konfirmimit subjekti do të njoftohet për të vazhduar ose jo procedurat për licensë për këtë veprimtari.

Ploteso në një dokument të vecantë strukturën organizative dhe listën e punëmarrësve që do të manipulojnë me burimin/et radioaktiv/e dhe pajisjen ku është inkorporuar, që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara. Ploteso dokumentacionin në lidhje me kualifikimet dhe eksperiencat e stafit. Të ngarkohen diplomë/certifikatë që vërteton kompetencën profesionale të tij/saj në lidhje me punën që do të kryejë, si dhe certifikatë trajnimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese lëshuar nga institucionet e njohura nga KMR, të ngarkohet vërtetimi i testimit. Ritrajnimi dhe testimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet kryhet cdo pesë vjet. Për realizimin e trajnimit dhe testimit të njohurive në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, referoju faqes zyrtare, <http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/> ku përcaktohen institucionet e njohura për këtë qëllim.

Pika 12- Kontrata për dozimetrinë personale, e cila të jetë e përshtatshme për llojin dhe energjitë e rrezatimit që keni në përdorim. Kontrata të paraqesë qartë detyrimet e secilës palë. Të kontaktohet Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar për nënshkrimin e kësaj kontrate.

Pika 13- Nje dokument me të dhënat mbi personin përgjegjës për sigurinë ndaj rrezatimit. Në qoftë se personi përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet nuk gjendet në listën e punëmarrësve të bashkëngjitet diploma/dëshmi që të vërtetojë aftësitë profesionale të tij/saj, certifikatë trajnimi dhe testimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese brenda pesë viteve të fundit, lëshuar nga institucione të njohura nga KMR. Të Plotesoet kontrata e punës për personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet.

Të plotësohen të dhënat mbi personin përgjegjës për sigurimin fizik të objektit ku kryhet veprimtaria. Në qofte se personi përgjegjës për sigurimin fizik të objektit ku kryhet veprimtaria nuk gjendet në listën e punëmarrësve të bashkëngjitet diploma/dëshmi që të vërtetojë aftësitë



profesionale të tij/saj. Të Plotesoet kontrata e punës për personin përgjegjës për sigurimin fizik të objektit ku kryhet veprimtaria.



KËRKESE PËR LICENSE PËR VEPRIMTARI ME BURIME RADIOAKTIVE

TRANSPORT

- Personi juridik/ fizik: _____
Emri, Mbiemri(përfaqësuesi ligjor) _____
Adresa _____
Tel _____
E-mail _____
Ekstrakti i regjistrimit në QKB _____

Nga sistemi

- Ploteso të dhëna të cilat ndikojnë në sigurinë gjatë transportit të burimeve radioaktive. Ploteso një informacion në lidhje me kategoritë e burimeve që do të transportohen _____
- Ploteso me shkrim një informacion se si do kryhet shërbimi i ngarkimit dhe shkarkimit të burimeve ose materialeve radioaktive _____
- Ploteso të dhëna mbi personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet
Emri _____
Mbiemri _____
- Ploteso të dhëna mbi personin përgjegjës për sigurimin fizik të objektit ku kryhet veprimtaria ku përdoren burime radioaktive
Emri _____
Mbiemri _____

Dokumenta për tu ngarkuar në sistem sipas renditjes:

- Ngarko foto të automjetit përfshi dhe foto të zonës së ngarkesës, ku të jetë e dukshme targa e automjetit.
- Ngarko leja e drejtimit ADR e drejtuesit të automjetit,
- Ngarko kontrata e punës e drejtuesit të automjetit.
- Ngarko leje/et e qarkullimit
- Ngarko rregullore e brendshme për transportin e burimeve radioaktive
- Ngarko një dokument vecantë për strukturën organizative
- Ngarko listën e punëmarrësve që do të manipulojnë me burimin/et radioaktiv/e dhe pajisjen ku është inkorporuar, që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara.
- Ngarko diplomë ose çertifikatë profesionale për çdo punëmarrës që lidhet me veprimtarinë
- Ngarko Çertifikatë trajnimit për çdo punëmarrës që lidhet me veprimtarinë. Vërtetimi testimi për çdo punëmarrës që lidhet me veprimtarinë
- Ngarko kontratën me Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar për monitorimin e dozës së ekspozimit të punëmarrësve gjatë punës me burimet radioaktive sipas listës së deklaruar të punëmarrësve



11. Ngarko Kontratën e punës për personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet me punëdhënësin dhe kualifikime të veçanta
12. Ngarko Kontratën e punës për personin përgjegjës për sigurimin fizik, me punëdhënësin dhe kualifikime të veçanta
13. Ngarko Planin e përgatitjes dhe reagimit në rast incidenti, aksidenti ose event radiologjik
14. Ngarko Dokument mbi mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit
15. Ngarko Raportin mjekësor i aftësisë për punë me burime radioaktive lëshuar nga Instituti i shendetit Publik për çdo punëmarrës që lidhet me veprimtarinë
16. Ngarko mandat pagesen me nr unik te kerkeses

Të gjithë burimet radioaktive duhet të transportohen tek përdorues që disponojnë licensën përkatëse për posedimin e burimeve radioaktive.

Kerkuesi mban përgjegjësi të plotë ligjore për vërtetësinë e të dhënave.

I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format pdf me ngjyra, me siglat dhe vulat lidhese ne cdo faqe nga ana e personit juridik fizik.

Kërkesa e plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për subjektin që aplikon për licencë. Bazuar në nenin 3 të rregullores Nr. 10 datë 7.01.2010 për licencim dhe inspektim për marrjen e licencës, çdo person juridik dhe fizik aplikon jo më vonë se 90 ditë punë para parashikimit për fillimin e veprimtarisë. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të licencës jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit.

Në rast se kërkesa për licencë ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Pr. Administrative, afati për shqyrtimin e saj fillon nga plotësimi i dokumentacionit.

Shënim :

- 1.Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me Ligjin nr.8025, datë 09.11.1995, i ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.
2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standardeve bazë të mbrojtjes nga rrezatimet , Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burimetë rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.

Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për licensë
Burime radioaktive
Transport

Pika 6- Subjektet që do të kryejnë transport të burimeve radioaktive të kategorisë 1,2 dhe 3 duhet të dërgojnë paraprakisht në ZMR, para fillimit të plotësimit të procedurave për licensë,listën e punonjësve që do të kryejnë transportin apo kanë infomacion mbi burimet radioaktive të kategorisë



1,2 dhe 3 që do të transportohen, me qëllim dërgimin në strukturat përkatëse për verifikimin e besueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre. Informacioni duhet të përfshijë për secilin të dhënat e mëposhtme;

1. Emër /mbiemër 2. Funksioni 3. Nr. i kartës së identitetit/ose pashaportës 4. Nr. Personal 5. Vendlindja 6. Vendbanimi 7. Ditëlindja 8. Shtetësia

Pas marrjes së konfirmimit subjekti do të njoftohet për të vazhduar ose jo procedurat për licensë për këtë veprimtari .

Të ngarkohen diplomë/çertifikatë që vërteton kompetencën profesionale të tij/saj në lidhje me punën që do të kryejë, si dhe çertifikatë trajnimit në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese lëshuar nga institucionet e njohura nga KMR, të ngarkohet vërtetimi i testimit. Ritrajnimit dhe testimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet kryhet çdo pesë vjet. Për realizimin e trajnimit dhe testimit të njohurive në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, referoju faqes zyrtare, <http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/> ku përcaktohen institucionet e njohura për këtë qëllim.

Pika 10- Të plotësohet një kopje e kontratës për dozimetrinë personale, e cila të jetë e përshtatshme për llojin dhe energjitë e rrezatimit që keni në përdorim. Kontrata të paraqesë qartë detyrimet e secilës palë. Të kontaktohet Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar për nënshkrimin e kësaj kontrate. Kontrata të ngarkohet në sistem.

Pika 14- Plotëso me shkrim mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit për të gjithë transportin e burimeve radioaktive dhe pajisjet ku janë të inkuorporuara sipas lejes së importit, çertifikatën e cilësisë së burimit radioaktiv, kategorinë e burimit radioaktiv, informacion mbi kontejnerët dhe tipet e paketimit, dozimetrinë personale, incidentet, trajnimit dhe kontrolli mjekësor periodik i punëmarrësve etj.

.



KËRKESË PËR LICENSE PËR VEPRIMTARI ME BURIME RADIOAKTIVE
PËRDORIM
KERKESA BEHET PER CDO BURIM

- Personi juridik/ fizik: _____
Emri, Mbiemri(përfaqësuesi ligjor) _____
Adresa _____
Adresa ku kryhet veprimtaria, nqs është e ndryshme nga më sipër _____
Tel _____
E-mail _____
Ekstrakti i regjistrimit në QKB _____

Nga sistemi

- Të dhëna mbi burimin/et radioaktiv/e, dhe pajisjeve ku janë inkomporuar.

Burim/e radioaktiv/e:

Prodhuesi _____

Nr. Modelit _____

Nr. Serisë _____

Adresa e prodhuesit _____

Radionuklidi _____

Aktiviteti fillestar _____

Aktiviteti ne ditën e kerkeses _____

Energjitë _____

Forma kimike dhe fizike _____

Pajisja ku është inkomporuar burimi radioaktiv:

Prodhuesi i pajisjes _____

Modeli i pajisjes _____

Numri i serisë i pajisjes _____

- Qëllimi i përdorimit të burimit radioaktiv _____

- Përshkruaj se kush do të kryejë shërbime të autorizuar të pajisjeve ku është i inkomporuar burimi radioaktiv ose për vetë burimin _____
- Ploteso me shkrim informacion të dozave efektive
në zonat publike _____
në zonat e kontrolluara _____
në zonat e survejuara _____



- Ploteso me shkrim informacion mbi justifikimin, optimizimin e ekspozimeve të publikut, stafit dhe pacientëve dhe kufizimin e ekspozimeve publike dhe të stafit, për përdorimin e burimeve radioaktive _____
- Ploteso të dhëna mbi personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet
Emri _____
Mbiemri _____
- Ploteso të dhëna mbi personin përgjegjës për sigurimin fizik të objektit ku kryhet veprimtaria ku përdoren burime radioaktive
Emri _____
Mbiemri _____
- Të Plotesohen dokumente në lidhje me çmontimin, trajtimin e sigurtë të burimit/eve radioaktiv/e të konsumuara, duke garantuar trajtimin në qendrat përkatëse të mbetjeve radioaktive në fund të përdorimit. Subjekti duhet të paraqesë me shkrim argumenta për garanci financiare për trajtimin e burimit të konsumuar kthim ne origjine ose ne qendrat per trajtim _____

Dokumenta për tu ngarkuar në sistem sipas renditjes

1. Ngarko Planimetrinë me të dhënat
2. Ngarko Dokument zyrtar mbi destinacionin e ambientit
3. Ngarko Plani i sigurimit për burimet radioaktive
4. Ngarko Dokument në lidhje me mënyrën se si është përfituar burimi radioaktiv, (Dokumenti i blerjes/dhurimit).
5. Ngarko Çertifikatën/at e cilësisë së burimit/eve lëshuar nga prodhuesi.
6. Ngarko Raportin e vlerësimit të sigurisë dhe mbrojtjes nga rrezatimet
7. Ngarko Rregullore e brendshme për përdorimin e burimeve radioaktive
8. Ngarko Një dokument veçantë strukturën organizative
9. Ngarko Listën e punëmarrësve që do të manipulojnë me burimin/et radioaktiv/e dhe pajisjen ku është inkuorporuar, që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara.
10. Ngarko Diplomë ose çertifikatë profesionale për çdo punëmarrës qe lidhet me veprimtarine
11. Ngarko Çertifikatë trajnimi për çdo punëmarrës qe lidhet me veprimtarine. Vërtetim testimi për çdo punëmarrës qe lidhet me veprimtarine
12. Ngarko Kontratën me Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar për monitorimin e dozës së ekspozimit të punëmarrësve gjatë punës me burimet radioaktive sipas listës së deklaruar të punëmarrësve
13. Ngarko Kontratën e punës për personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet me punëdhënësin dhe kualifikime të veçanta



14. Ngarko Kontratën e punës për personin përgjegjës për sigurimin fizik, me punëdhënësin dhe kualifikime të veçanta
15. Nagrko Planin e përgatitjes dhe reagimit në rast incidenti, aksidenti ose event radiologjik
16. Ngarko Kontratën për kthimin në vendin e origjinës, ose kontratën për trajtimin në një qendër të licencuar për trajtimin e mbetjeve radioaktive.
17. Ngarko Dokument mbi mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit
18. Ngarko me tabelë inventarin me karakteristikat dhe të dhënat e burimeve radioaktive në përdorim
19. Ngarko Formatin e rregjistrimit të shkarkimeve në mjedis
20. Ngarko Formatin mbi njoftimin e humbjes, vjedhjes ose sabotimit,
21. Ngarko Raportin mjekësor i aftësisë për punë me burime radioaktive lëshuar nga ISHP për çdo punëmarrës
22. Ngarko mandat pagesen me nr unik te kerkeses

Kerkuesi mban përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e të dhënave.

I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format pdf me ngjyra, me siglat dhe vulat lidhese ne cdo faqe nga ana e personit juridik fizik.

Kërkesa e plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për subjektin që aplikon për licencë. Bazuar në nenin 3 të rregullores Nr. 10 datë 7.01.2010 për licencim dhe inspektim për marrjen e licencës, çdo person juridik dhe fizik aplikon jo më vonë se 90 ditë punë para parashikimit për fillimin e veprimtarisë. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të licencës jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit.

Në rast se kërkesa për licencë ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Pr. Administrative, afati për shqyrtimin e saj fillon nga poltesimi i gjithë dokumentacionit.

Shënim :

1.Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me Ligjin nr.8025, datë 09.11.1995, i ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.

2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standardeve bazë të mbrojtjes nga rrezatimet , Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burimetë rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.

Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për licenë
Përdorim
Burime radioaktive



Pika 1- Planimetria të Plotesohet në një format të përshtatshëm dhe të specifikojë në mënyrë të dukshme të gjithë elementët, ambientet, vendndodhjen e burimit radioaktiv, pajisjeve mbrojtëse të lëvizshme, dyerve, dritareve, ventilatorëve, pasazheve, ambienteve të pritjes së pacientëve, qëndrimin e personelit, ambientet rreth kabinetit, materialin dhe dimensionet përkatëse. Ploteso me ngjyra zonat e kontrolluara, të survejuara dhe zonat publike.

Pika 2-Të dokumentohet destinacioni i ambienteve. Të Plotesoet një dokument zyrtar, i cili përcakton destinacionin e ambienteve ku do ushtrohet veprimtaria. (Sipas Urdhrit Nr. 415, datë 11.10.2011, i Ministrit të Shëndetësisë për ndërtimin e kabineteve të radiologjisë dhe ato me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive).

Pika 3-Të Plotesohet plani i sigurimit për burimet radioaktive të kategorisë I,II dhe III sipas udhëzuesit të KMR nr.444/8 datë 29/03/2019. Të Plotesoet plani i sigurimit fizik për përdorimin e burimeve radioaktive të kategorisë I, II dhe III, i cili të jetë në përputhje me rregulloren Nr.877 datë 30.10.2015 ”Mbi sigurimin fizik të materialeve radioaktive” si dhe udhëzuesin Nr.444/8 datë 29.03.2019.

Për përgatitjen e këtij plani të kontaktohet personi i ngarkuar nga Policia e Shtetit në Drejtoritë vendore të policisë /komisariati i policisë ,aty ku subjekti ushtron veprimtarinë për ruajtje /trajtim të burimeve radioaktive të kategorisë 1,2 dhe 3,

Referoju faqes zyrtare të internetit <http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/>.

Pika 6- Të Plotesohet vlerësimi për sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimi nga Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar. Ploteso me shkrim një informacion në rast se ka shkarkime në mjedis.

Për realizimin e raport ekspertizës referoju faqes zyrtare, <http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/>.

Vlerësimi për sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimi të bëhet në analogji me udhëzimin e miratuar nga KMR nr.72/21 datë 17/08/2021.

Pika 9- Subjektet që do të përdorin burimeve radioaktive të kategorisë 1,2 dhe 3 duhet të dërgojnë paraprakisht në ZMR, para fillimit të plotësimit të procedurave për licensë/amendim/rinovim,listën e punonjësve që do të kenë akses dhe informacion mbi burimet radioaktive të kategorisë 1,2 dhe 3 ,me qëllim dërgimin në strukturat përkatëse për verifikimin e besueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre.Informacioni duhet të përfshijë për secilin të dhënat e mëposhtme;

1.Emër /mbiemër 2.Funksioni 3.Nr. i kartës së identitetit/ose pashaportës 4.Nr.Personal 5.Vendlindja 6.Vendbanimi 7.Ditëlindja 8.Shtetësia

Pas marrjes së konfirmimit subjekti do të njoftohet për të vazhduar ose jo procedurat për licensë për këtë veprimtari .

Ploteso në një dokument veçantë listën e punëmarrësve të miratuar që do të manipulojnë me burimin/et radioaktiv/e dhe pajisjen ku është inkorporuar, që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara. Ploteso dokumentacionin në lidhje me kualifikimet dhe eksperiencat e stafit. Të ngarkohen diplomë/çertifikatë që vërteton kompetencën profesionale të tij/saj në lidhje me punën që do të kryejë, si dhe çertifikatë trajnimit në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese lëshuar nga institucionet e njohura nga KMR, të ngarkohet vërtetimi i testimit. Ritrajnimit dhe testimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet kryhet çdo pesë vjet. Për realizimin e trajnimit dhe testimit të



njohurive në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, referoju faqes zyrtare, <http://www.ishp.gov.al/te-pergjithshme/> ku përcaktohen institucionet e njohura për këtë qëllim.

Pika 12- Ploteso kontratën me Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, Tiranë, për monitorimin e dozës së ekspozimit të punëmarrësve gjatë punës me burimet radioaktive sipas listës së deklaruar të punëmarrësve e cila të jetë e përshtatshme për llojin dhe energjitë e rrezatimit që keni në përdorim. Për praktikën siç përcaktohen në nenin 31 të VKM nr.801 datë 11/12/2019 për të cilat nuk është e nevojshme nënshkrimi i kontratës për dozimetrimin personale me IFBZ të kryhet monitorimi i vendit të punës nga përgjegjësi i mbrojtjes nga rrezatimet ose nga një ekspert i mbrojtjes nga rrezatimet.

Pika 14- Të ngarkohen diplomë/çertifikatë që vërteton kompetencën profesionale të tij/saj në lidhje me punën që do të kryejë, si dhe çertifikatë trajnimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese lëshuar nga institucionet e njohura nga KMR, të ngarkohet vërtetimi i testimit. Ritrajnimi dhe testimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet kryhet çdo pesë vjet. Për realizimin e trajnimit dhe testimit të njohurive në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, referoju faqes zyrtare, <http://www.ishp.gov.al/te-pergjithshme/> ku përcaktohen institucionet e njohura për këtë qëllim.

Pika 17- Të Plotesohet një dokument mbi mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit për të gjithë burimet radioaktive dhe pajisjet ku janë të inkuorpuara sipas lejes së importit, informacion mbi lejen/lejet e import/eksportit të lëshuara nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet ose Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, çertifikatën e cilësisë së burimit radioaktiv, kategorinë e burimit radioaktiv, informacion mbi kontejnerët dhe tipet e paketimit, dozimetrimin personale, izodozave , incidenteve , trajnimit , shërbimeve të pajisjeve dhe kontrolli mjekësor periodik i punëmarrësve etj.



KËRKESË PËR LICENSE PËR VEPRIMTARI ME GJENERATORË / LLAMPË ME RREZE
X
INSTALIM/MIRËMBAJTJE

- Personi juridik/ fizik: _____
Emri, Mbiemri(përfaqësuesi ligjor) _____
Adresa _____
Tel _____
E-mail _____
Ekstrakti i regjistrimit në QKB _____

Nga sistemi

- Ploteso të dhëna mbi personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet
Emri _____
Mbiemri _____

Duke mbajtur përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e të dhënave të mësipërme.

Dokumenta për tu ngarkuar në sistem sipas renditjes

1. Ngarko Një dokument veçantë strukturën organizative
2. Ngarko Listën e punëmarrësve që do të manipulojnë me gjeneratorë/llampë me rreze x, që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara.
3. Ngarko Diplomë ose certifikatë profesionale për çdo punëmarrës që lidhet me veprimtarinë
4. Ngarko Çertifikatë trajnimi për çdo punëmarrës që lidhet me veprimtarinë. Vërtetim testimi për çdo punëmarrës që lidhet me veprimtarinë
5. Ngarko Kontratën me Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar për monitorimin e dozës së ekspozimit të punëmarrësve gjatë punës me gjeneratorë me rreze x sipas listës së deklaruar të punëmarrësve
6. Ngarko Kontratën e punës për personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet me punëdhënësin dhe kualifikime të veçanta
7. Ngarko Planin e reagimit në rast incidenti .
8. Ngarko Rregullore e brendshme për instalimin dhe mirëmbajtjen e gjeneratorëve/llampave me rreze x.
9. Ngarko Dokument mbi mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit
10. Ngarko Raportin e vlerësimit të sigurisë dhe mbrojtjes nga rrezatimet
11. Ngarko Deklaratë për mosinstalimin e gjeneratorëve me rreze x në kundërshtim me urdhërin nr.415 datë 11/10/2011 mbi destinacionin e ambientit ku ushtrohet veprimtaria .
12. Ngarko Raportin mjekësor i aftësisë për punë me burime radioaktive lëshuar nga ISHP për çdo punëmarrës.



13. Ngarko mandat pagesen me nr unik te kerkeses

Kerkuesi mban përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e të dhënave.

I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format pdf me ngjyra, me siglat dhe vulat lidhese ne cdo faqe nga ana e personit juridik fizik.

Kërkesa e plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për subjektin që aplikon për licencë. Bazuar në nenin 3 të rregullores Nr. 10 datë 7.01.2010 për licencim dhe inspektim për marrjen e licencës, çdo person juridik dhe fizik aplikon jo më vonë se 90 ditë punë para parashikimit për fillimin e veprimtarisë. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të licencës jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit.

Në rast se kërkesa për licencë ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Pr. Administrative, afati për shqyrtimin e saj fillon nga plotësimi i gjithë dokumentacionit.

Shënim :

- 1.Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me Ligjin nr.8025, datë 09.11.1995, i ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.
2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standardeve bazë të mbrojtjes nga rrezatimet, Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.

Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për licencë
Gjeneratorë/llampë me rreze x
Instalim/mirëmbajtje

Pika 1- Të ngarkohen diplomë/çertifikatë që vërteton kompetencën profesionale të tij/saj në lidhje me punën që do të kryejë, si dhe çertifikatë trajnimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese lëshuar nga institucionet e njohura nga KMR, të ngarkohet vërtetimi i testimit. Për realizimin e trajnimit dhe testimit të njohurive në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, referoju faqes zyrtare, <http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/> ku përcaktohen institucionet e njohura për këtë qëllim.

Pika 5- Të ngarkohet kontrata për dozimetritë personale, e cila të jetë e përshtatshme për llojin dhe energjitë e rrezatimit me të cilat do manipuloni. Kontrata të paraqesë qartë detyrimet e secilës palë. Të kontaktohet Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar për nënshkrimin e kësaj kontrate.

Pika 6- Të ngarkohen të dhënat mbi personin përgjegjës për sigurinë ndaj rrezatimit. Në qoftë se personi përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet nuk gjendet në listën e punëmarrësve, të bashkëngjitet diploma/dëshmi që të vërtetojë aftësitë profesionale të tij/saj, çertifikatë trajnimi dhe testimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese brenda pesë viteve të fundit, lëshuar nga



institucione të njohura nga KMR. Të Plotesoet kontrata e punës për personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet.

Pika 9- Të përshkruhet me shkrim mënyra e ruajtjes së të dhënave për dozimetrinë personale, incidenteve, trajnimit, testimi i stafit, shërbimeve të pajisjeve dhe kontrolli mjekësor periodik i punonjësve. Te krijoje një bazë të dhënash për çdo pajisje që instalohet/mirëmbahet. Ploteso formatin e kësaj baze të dhënash, ku të jetë i përfshirë dhe numri i lejes së importit të pajisjes.

Pika 10-Të Plotesoet vlerësimi për sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimi, i cili merr në konsideratë gjatë instalimit/mirëmbajtjes si me poshtë:

Ngarkesa vjetore maksimale

Faktori i përdorimit

Pajisjet mbrojtëse të lëvizshme dhe ato personale

Rrethanat e posaçme

Vendosja e shenjave të rrezikut të rrezatimit jonizues

Instrumentet matëse dhe kalibrimi i tyre

Teste për rrjedhje etj.

Për realizimin e raport ekspertizës referoju faqes zyrtare, <http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/> ku përcaktohet lista e personave/institucioneve të njohur nga KMR për realizimin e raportit/ekspertizën mbi sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese.

Subjektet private për kryerjen e ekspertizës ti referohen listës së ekspertëve të njohur nga KMR, ndërsa subjektet shtetërore të kontaktojnë Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, sic përcaktohet në faqen zyrtare.



KËRKESË PËR LICENSE PËR VEPRIMTARI ME BURIME RADIOAKTIVE
PRODHIM
PER CDO BURIM RADIATIV QE PRODHOHET

- Personi juridik/ fizik: _____
Emri, Mbiemri(përfaqësuesi ligjor) _____
Adresa _____
Adresa ku kryhet veprimtaria, nqs është e ndryshme nga më sipër _____
Tel _____
E-mail _____
Ekstrakti i regjistrimit në QKB _____

Nga sistemi

- Ploteso me shkrim informacion të dozave në zonat publike _____
në zonat e kontrolluara _____
në zonat e survejuara _____
- Ploteso të dhëna mbi personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet
Emri _____
Mbiemri _____
- Ploteso të dhëna mbi personin përgjegjës për sigurimin fizik të objektit ku kryhet
veprimtaria ku prodohen burime radioaktive
Emri _____
Mbiemri _____

Dokumenta për tu ngarkuar në sistem sipas renditjes

1. Ngarko Planimetrinë me të dhënat
2. Ngarko Dokument zyrtar mbi destinacionin e ambientit
3. Ngarko Plani i sigurimit për burimet radioaktive
4. Ngarko Raportin e vlerësimit të sigurisë dhe prezantimi i “safety”
5. Ngarko me tabelë inventarin me karakteristikat dhe të dhënat e burimeve radioactive qe prodhohen etj.
6. Ngarko Programin e monitorimit të mjedisit
7. Ngarko Rregullore e brendshme për prodhim e burimeve radioaktive
8. Ngarko Një dokument vecantë strukturën organizative
9. Ngarko Listën e punëmarrësve që do të manipulojnë me burimin/et radioaktiv/e dhe pajisjen ku është inkuorporuar, që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara.
10. Ngarko Diplomë ose certifikatë profesionale për çdo punëmarrës qe lidhet me veprimtarine.
11. Ngarko Certifikatë trajnimi për çdo punëmarrës qe lidhet me veprimtarine. Vërtetim testimi për çdo punëmarrës qe lidhet me veprimtarine.



12. Ngarko Kontratën me Institutin e Fizikës Bërthamore të Zbatuar për monitorimin e dozës së ekspozimit të punëmarrësve gjatë punës me burimet radioaktive sipas listës së deklaruar të punëmarrësve
13. Ngarko Kontratën e punës për personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet me punëdhënësin dhe kualifikime të veçanta
14. Ngarko Planin e përgatitjes dhe reagimit në rast incidenti, aksidenti ose event radiologjik
15. Ngarko Formatin dhe rregjistrin kombëtar të burimeve radioaktive të prodhuara,
16. Ngarko Formatin e rregjistrit të shkarkimeve në mjedis
17. Ngarko Formatin mbi njoftimin e humbjes, vjedhjes ose sabotimit,
18. Ngarko Raportin mjekësor i aftësisë për punë me burime radioaktive lëshuar nga Instituti i Shendetit Publik për çdo punëmarrës që lidhet me veprimtarinë
19. Ngarko mandatin pagesën me nr unik të kërkesës

Kerkuesi mban përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e të dhënave.

Burimet radioaktive nuk transferohen në subjekte të cilat nuk disponojnë licensën përkatëse. I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format pdf me ngjyra, me siglat dhe vulat lidhese në çdo faqe nga ana e personit juridik fizik.

Kërkesa e plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për subjektin që aplikon për licensë. Bazuar në nenin 3 të rregullores Nr. 10 datë 7.01.2010 për licencim dhe inspektim për marrjen e licensës, çdo person juridik dhe fizik aplikon jo më vonë se 90 ditë punë para parashikimit për fillimin e veprimtarisë. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të licensës jo më vonë se 180 ditë kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit.

Në rast se kërkesa për licensë ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Pr. Administrative, afati për shqyrtimin e saj fillon nga Plotesoja e plotë e dokumentacionit.

Shënim :

1. Veprimtaria me burime të rrezatimeve jonizuese realizohet në përputhje me Ligjin nr.8025, datë 09.11.1995, i ndryshuar, si dhe të rregulloreve, kodeve dhe praktikave të aprovuara.
2. Në bazë të ligjit për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe të standardeve bazë të mbrojtjes nga rrezatimet, Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimet jonizuese duhet të njoftohet për çdo veprimtari me burime të rrezatimeve jonizuese, pezullimin ose mbylljen e tyre.

Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për licensë
Burime radioaktive
Prodhim

Pika 1- Planimetria të Plotesoet në një format të përshtatshëm dhe të specifikojë në mënyrë të dukshme të gjithë elementët, ambientet, vendndodhjen e burimit/eve radioaktiv/e, pajisjeve mbrojtëse të lëvizshme, dyerve, dritareve, ventilatorëve, pasazheve, qëndrimin e personelit,



ambientet rreth instalimit, materialin dhe dimensionet përkatëse. Ploteso me ngjyra zonat e kontrolluara, tëurvejuara dhe zonat publike.

Pika 2-Të dokumentohet destinacioni i ambienteve. Të Plotesoet një dokument zyrtar, i cili përcakton destinacionin e ambienteve ku do ushtrohet veprimtaria. (Sipas Urdhrit Nr. 415, datë 11.10.2011, i Ministrisë të Shëndetësisë për ndërtimin e kabineteve të radiologjisë dhe ato me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive). Te ngarkohet vertetim pronësie nga ASHK.

Pika3-Të Plotesoet plani i sigurimit për burimet radioaktive të kategorisë I, II dhe III sipas udhëzuesit të KMR nr.444/8 datë 29/03/2019. Të Plotesoet plani i sigurimit fizik për përdorimin e burimeve radioaktive të kategorisë I, II dhe III, i cili të jetë në përputhje me rregulloren Nr.877 datë 30.10.2015 ”Mbi sigurimin fizik të materialeve radioaktive” si dhe udhëzuesin Nr.444/8 datë 29.03.2019.

Për përgatitjen e këtij plani të kontaktohet personi i ngarkuar nga Policia e Shtetit në Drejtorinë vendore të policisë /komisariati i policisë ,aty ku subjekti ustron veprimtarinë për ruajtje/trajtim të burimeve radioaktive të kategorisë 1,2 dhe 3 .

Referoju faqes zyrtare të internetit <http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/>.

Pika 4- Raporti i vlerësimit të sigurisë, të përmbajë vlerësimin për sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimi në analogji me udhëzimin e miratuar nga KMR nr.72/21 datë 17/08/2021. Planin të përmbajë elementët e mëposhtëm, në përputhje me rregulloren nr.801/2019 në Republikën e Shqipërisë.

- Qëllimi i prodhimit, dhe gjithë procedura se si do prodhohet materiali radioaktiv.
- Ku do prodhohet si prodhohet dhe ku do ruhen burimet/eve radioaktiv/e
- programet operative të menaxhimit të te prodhimit,
- financimin për prodhimin dhe trajtimin e mbetjeve,
- kushtet e përgjithshme për kontrollin e prodhimit,
- minimizimin e prodhimit të mbetjeve,
- ripërdorimin dhe riciklimin e burimeve që nuk përdoren më
- heqjen nga kontrolli rregullator
- Kriteret e prodhimit
- sqarime mbi mos hollimin e mbetjeve me qëllim shkarkimet në mjedis
- shkarkimi i mbetjeve radioaktive në mjedis
- karakteristikat e prodhimit dhe mbetjeve radioaktive
- paketimi
- kushtet e përgjithshme për ruajtjen e përkohëshme
- elemente të depos për ruajtje të përkohëshme
- kushtet speciale
- programi i monitorimit
- rishikime periodike të sigurisë, Ploteso me shkrim një informacion në lidhje me
- elementë të përgjithshme për ndërtimin e qendres prodhuese
- programi i monitorimit
- rishikime periodike të sigurisë



Ploteso me shkrim një dokument me informacion mbi shërbimet bazë, pajisjet që do të përdoren për ruajtjen dhe trajtimin e burimeve radioaktive. Sqaro në detaje proceset që do të kryhen dhe pajisjet që do të përdoren.

Ploteso me shkrim informacion mbi justifikimin dhe kufizimin e ekspozimeve publike dhe të stafit në procesin e ruajtjes dhe trajtimit të burimeve radioaktive

Pika 8- Subjektet që do prodhojnë materiale radioaktive të kategorisë 1,2 dhe 3 duhet të dërgojnë paraprakisht në ZMR, para fillimit të plotësimit të procedurave për licensë /amenim/rinovim ,listën e punonjësve që do të kenë akses /infomacion mbi burimet radioaktive të kategorisë 1, 2 dhe 3, me qëllim dërgimin në strukturat përkatëse për verifikimin e besueshmërisë dhe përshtatshmërinë e tyre. Informacioni duhet të përfshijë për secilin të dhënat e mëposhtme;

1.Emër/mbiemer 2.Funksioni 3.Nr.i kartes së identitetit/ose pashaportës4.Nr.Personal 5.Vendlindja 6.Vendbanimi 7.Ditëlindja 8.Shtetësia

Pas marrjes së konfirmimit subjekti do të njoftohet për të vazhduar ose jo procedurat për licensë për këtë veprimtari.

Ploteso në një dokument të vecantë strukturën organizative dhe listën e punëmarrësve që do të manipulojnë me burimin/et radioaktiv/e dhe pajisjen ku është inkorporuar, që kanë akses në zonat e kontrolluara dhe survejuara. Ploteso dokumentacionin në lidhje me kualifikimet dhe eksperiencat e stafit. Të ngarkohen diplomë/certifikatë që vërteton kompetencën profesionale të tij/saj në lidhje me punën që do të kryejë, si dhe certifikatë trajnimit në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese lëshuar nga institucionet e njohura nga KMR, të ngarkohet vërtetimi i testimit. Ritrajnimit dhe testimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet kryhet cdo pesë vjet. Për realizimin e trajnimit dhe testimit të njohurive në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet, referoju faqes zyrtare, <http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/> ku përcaktohen institucionet e njohura për këtë qëllim.

Pika 12- Të Plotesoet një kopje e kontratës për dozimetrimin personale, e cila të jetë e përshtatshme për llojin dhe energjitë e rrezatimit që keni në përdorim. Kontrata të paraqesë qartë detyrimet e secilës palë. Të kontaktohet Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar për nënshkrimin e kësaj kontrate.

Pika 13- Të plotësohen të dhënat mbi personin përgjegjës për sigurinë ndaj rrezatimit. Në qoftë se personi përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet nuk gjendet në listën e punëmarrësve të bashkëngjitet diploma/dëshmi që të vërtetojë aftësitë profesionale të tij/saj, certifikatë trajnimit dhe testimi në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese brenda pesë viteve të fundit, lëshuar nga institucione të njohura nga KMR. Të Plotesohet kontrata e punës për personin përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet.

Të plotësohen të dhënat mbi personin përgjegjës për sigurimin fizik të objektit ku kryhet veprimtaria. Në qofte se personi përgjegjës për sigurimin fizik të objektit ku kryhet veprimtaria nuk gjendet në listën e punëmarrësve të bashkëngjitet diploma/dëshmi që të vërtetojë aftësitë profesionale të tij/saj. Të Plotesoet kontrata e punës për personin përgjegjës për sigurimin fizik të objektit ku kryhet veprimtaria.



KERKESE REGJISTRIMI I VEPRIMTARISË
PËRDORIM GRAFI DENTARE INTRAORALE

(PËR CDO PAJISJE)

- Personi juridik/ fizik: _____
Emri, Mbiemri(përfaqësuesi ligjor) _____
Adresa _____
Adresa ku kryhet veprimtaria, nqs është e ndryshme nga më sipër _____
Tel _____
E-mail _____
Ekstrakti i regjistrimit në QKB _____
- Plotëso të dhënat e pajisjes

Prodhuesi i pajisjes _____
Modeli i pajisjes _____
Numri i serisë i pajisjes _____
Tensioni maksimal _____
Rryma maksimale _____
Modeli i tubit me rreze X _____
Numri i serisë për tubin me rreze x _____

Ngarko:

1.Dokumentacion zyrtar i cili përcakton destinacionin e ambjenteve ku do të ushtrohet veprimtaria (Sipas Urdhrit Nr. 415, datë 11.10.2011, i Ministrisë të Shëndetësisë për ndërtimin e kabineteve të radiologjisë dhe ato me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive). Certifikatë Pronësie lëshuar nga ASHK.

2.Dokument në lidhje me mënyrën se si është përfituar pajisja (Dokumenti i blerjes/dhurimit)

Dokumentacioni të jetë i sigluar në cdo faqe nga përfaqësuesi ligjor i kompanisë/institucionit, të mbajë vulë lidhëse të kompanisë / institucionit në cdo faqe, të jetë i skanuar në format pdf me ngjyra .



NJOFTIM PËR MBYLLJE AKTIVITETI,
PËR VEPRIMTARI PËRDORIM TË GJENERATORËVE ME RREZE X
(PËR CDO PAJISJE)

1. Personi juridik/ fizik: _____
Emri, Mbiemri (përfaqësuesi ligjor) _____
Adresa _____
Adresa ku është kryer veprimtaria, nëq është e ndryshme nga më sipër _____
Tel _____
E-mail _____

2. Nr i licensës _____ data _____

3. Lloji i Gjeneratorit me rreze X:

Prodhuesi i pajisjes _____
Modeli i pajisjes _____
Numri i serisë i pajisjes _____
Tensioni maksimal _____
Rryma maksimale _____
Numri i tubave _____
Modeli për çdo tub me rreze x _____
Numrat e serisë për çdo tub me rreze x _____

Ngarko:

1. Deklaratë që njofton pushimin ose mbylljen e aktivitetit me gjeneratore me rreze X

2. Informacion mbi destinacionin e pajisjes gjenerator me rreze x:

a) Ngarko aprovimin e transferimit të gjeneratorit me rreze X tek personi fizik juridik i licensuar nga KMR

ose

b) Ngarko foto të cilat të demonstrojnë shkatërrimin e tubit me rreze x të pajisjes.

Dokumentacioni të jetë i sigluar në cdo faqe nga përfaqësuesi ligjor i kompanisë/institucionit, të mbajë vulë lidhëse të kompanisë / institucionit në cdo faqe, të jetë i skanuar në format pdf me ngjyra .





6)Ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 743, datë 16.10.2012 "Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese", e ndryshuar me VKM Nr. 67, datë 3.2.2017.

1. Togfjalëshi “aplikimi” zëvendësohet me “kërkesa” në secilin rast në përmbajtje të kësaj VKM.
2. Togfjalëshi “aplikimit” zëvendësohet me “kërkesës” në secilin rast në përmbajtje të kësaj VKM.
3. Togfjalëshi “aplikimin” zëvendësohet me “kërkesën” në secilin rast në përmbajtje të kësaj VKM.
4. Togfjalëshi “aplikant” dhe togfjalëshi “subjekt” zëvendësohet me “personat fizik ose juridik” në secilin rast në përmbajtje të kësaj VKM.
5. Togfjalëshi “Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi” zëvendësohet me “Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet” në secilin rast në përmbajtje të kësaj VKM.
Togfjalëshi “Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi” zëvendësohet me “Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet” në secilin rast në përmbajtje të kësaj VKM.
6. Pika 4.1 pas Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi shtohet togfjalëshi “për cdo stacion emetimi të fushës elektromagnetike (EMF)”.
7. Pika 4.3 ndryshohet si më poshtë; “ Për pajisjen me akt miratimi personat fizik e juridik plotësojnë kërkesën për akt miratim nëpërmjet paltformës elektronike e-albania, sipas formatit bashkëngjitur kësaj rregulloreje. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për të pajisur me akt miratimi ose jo, jo më vonë se 60 dite nga paraqitja e plotë e kërkesës.
8. Pika 4.7 ndryshohet si më poshtë:

“Kërkesa për akt miratim dhe dokumentacioni shoqërues i saj arkivohet elektronikisht në platformën e-albania ose sipas Ligjit Nr. 10237 datë 29.04.2010 “Për Dokumentin Elektronik” për cdo subjekt fizik ose juridik”.

9. Pika 4.8 ndryshohet si më poshtë :
“Pas miratimit nga KMR, akt miratimi dërgohet elektronikisht tek personi fizik juridik përkatës sipas formatit të miratuar nga KMR”.
10. Pika 4.9 ndryshohet si më poshtë:
“Për cdo ndryshim në burim që vjen si pasojë e ndryshimit teknologjik të shpërndarjes së rrezatimit, personat fizik ose juridik duhet të paraqesin kërkesë të re për akt miratim si dhe vlerësimin për shpërndarjen e rrezatimit nëpërmjet sistemit elektronik e-albania.”
Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për miratimin ose jo të aktit të miratimit jo më vonë se 60 ditë”.
11. Pas pikës 4.10 shtohet pika 4.11 si më poshtë:
“Formati “Kërkesë për akt miratim për veprimtarinë e burimeve të rrezatimeve jojonizuese” bashkëngjitur VKM shfuqizohet dhe zëvendësohet me formatin “Kërkesë për



akt miratimi për veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues përdorim për cdo stacion emetimi të fushës elektromagnetike(EMF)”.

12. Pika 5.1 ndryshohet si më poshtë:

“Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet kontrollon zbatimin e dispozitave që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese të gjitha veprimtarive të pajisura me akt miratim”.

13. Pas pikës 7.2 shtohet pika 7. 3 si më poshtë:

“Personat fizik ose juridik do të dorëzojnë dokumentacion në rrugë shkresore në Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimet për kërkesat për akt-miratim, të cilat nuk janë të pasqyruara në sistemin e-albania. Personat fizikë ose juridikë do të përdorin formatin e kërkesës për akt miratim të përshatur për procesin online, gjatë periudhës tranzitore deri në ofrimin e këtij shërbimi në platformën e-albania. Kërkesa të vecanta të cilat nuk gjenden online i dërgohen ZMR në rrugë shkresore”.



Aneksi I

KËRKESË PËR AKT MIRATIMI
PËR VEPRIMTARI ME BURIME TË RREZATIMIT JOJONIZUES
PËRDORIM
PER CDO STACION EMETIMI FEM

- Personi juridik/ fizik: _____
Emri, Mbiemri (përfaqësuesi ligjor): _____
Adresa: _____
Adresa ku kryhet veprimtaria (adresa e saktë e vendinstalimit të stacionit të emetimit FEM): _____
Tel: _____
E-mail: _____
Ekstrakti i regjistrimit në QKB _____

Nga sistemi

- Plotëso të dhëna mbi stacionin emetues me elementët e nevojshëm identifikues, të cilët do të paraqiten në Akt Miratimi.
- Plotëso të dhëna mbi ekspertin e njohur nga KMR.

Emër/Mbiemër: _____

Dokumenta për t'u ngarkuar në sistem sipas renditjes

1. Certifikata e konformitetit të pajisjeve për çdo pajisje të re
2. Raporti vlerësues i shpërndarjes së rrezatimit jojonizues
3. Ngarko mandat pagesen me nr unik te kerkeses

Personi fizik/juridik mban përgjegjësi të plotë ligjore për vërtetësinë e të dhënave në kërkesë.

I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format pdf me ngjyra, me siglat dhe vulat lidhese ne cdo faqe nga ana e personit juridik fizik.

Kërkesa e plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për pajisjen me akt miratimi. Bazuar në pikën 4.3 të VKM Nr.743 datë 16.10.2012 “Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese”, i ndryshuar, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet vendos për lëshimin e akt miratimit jo më vonë se 60 ditë pune nga kërkesa fillestare .

Në rast se kërkesa ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion, bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Pr. Administrative, afati për shqyrtimin e kërkesës fillon nga paraqitja e plotë e dokumentacionit.



Format shpjegues në lidhje me plotësimin e kërkesës për akt miratimi me burime të rrezatimit
jojonizues
Përdorim

Pika 1- Të ngarkohet një kopje e certifikatës së konformitetit të pajisjeve gjeneruese të rrezatimit lëshuar nga autoriteti përkatës dhe i njohur në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi.

Pika 2- Të ngarkohet Studimi për vlerësimin e shpërndarjes së rrezatimit jojonizues, i realizuar nga një ekspert i njohur nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR), sipas procedurës së vlerësimit të aplikimit për njohje nga KMR si ekspert i kualifikuar për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese Nr. 3618/3 datë 13/05/2014. Të përgatitet me shkrim nga ana e ekspertëve raporti mbi shpërhapjen e rrezatimit jojonizues në përputhje me dokumentin e miratuar nga KMR, Nr. 822/2 datë 13/02/2013, mbi metodikën e llogaritjes së përmasave të zonës kritike të shpërhapjes së rrezatimit, si dhe dokumente të tjera të miratuara nga ana e KMR-së. Ky raport duhet të jetë i firmosur në çdo faqe nga eksperti dhe nga personi fizik/juridik.

Në rastet e stacioneve bazë të përbashkëta, të deklarohej në faqen e parë të raportit të vlerësimit të shpërndarjes së fushës së rrezatimit elektromagnetik rreth stacionit për secilin person fizik/juridik nëse ka apo jo ndryshime të fushës elektromagnetike rreth stacionit.

Në çdo faqe të raportit të jetë e vendosur vula lidhëse e personit fizik/juridik.

Ekspertiza duhet të paraqesë gjeometrikisht pozicionin e celit (celeve) të një stacioni bazë, të një operatori tjetër në mastin/kullën të ngritur në çati-tarracë/tokë të burimeve të tjera të rrezatimeve jojonizuese, kur celet janë në distancë më të vogël se 50m me celet e stacionit bazë në raport.

Raporti vlerësues duhet të ketë një renditje metodike në plotësim të kërkesave rregullatore. Raporti duhet të reflektojë kërkesat e mbrojtjes së publikut në përputhje me rregulloren Nr. 743 dt. 16.10.2012, si më poshtë:

Të përshkruhet ambienti/tet ku kryhet veprimtaria me burime rrezatimi jojonizues.

Të jepen të dhëna të sakta mbi topografinë e instalimit të stacionit bazë për të cilin kërkohet akt miratimi. Të jepet një përshkrim i saktë i pozicionit të stacionit bazë, ndërtesave dhe objekteve rreth stacionit duke përfshirë distancat, katet dhe lartësitë e objekteve . Koordinatat gjeografike të jepen në formën xx° (grade) $xx.x'$ (minuta) $xxx.xx''$ (sekonda). Ky përshkrim të jepet në një planimetri format A3 dhe në një shkallë 1:200. Kjo planimetri të paraqesë pozicionin e stukturës ku janë instaluar antenat dhe azimutet e emërtuara.

Të paraqiten foto prezantuese të antenës, stacionit bazë dhe pozicionit të kullës (në tokë) dhe mastit (në tarracë-çati, etj) si dhe objekteve dhe ndërtesave rreth stacionit.



Para paraqitjes së kërkesës për akt miratimi, operatorët të sigurojnë nëse ka hapësirë të mëtijshme për të shtuar frekuenca të reja/rritur fuqi në atë zonë, brenda limiteve rregullatore.

Eksperti duhet të paraqesë në raport:

- Tipet e antenave të instaluar.
- Lartësinë e pozicionimit të burimit të rrezatimit jojonizues.
- Fuqitë në hyrje në çdo cel për çdo bandë dhe bandat e frekuencave të operimit.
- Koeficientët e amplifikimit në lobin qendror të antenës dhe koeficientin e amplifikimit në lobin dytësor më të madh (të nxjerra nga të dhënat e pasaportës së antenës).
- Azimutin e çdo celi.
- Përkuljet mekanike dhe elektrike të çdo celi.
- Këndi i hapjes vertikale të tufës së çdo antene.
- Lartësinë e pikës mbi të cilën janë bërë llogaritjet.
- Nëse ka cele të afërta që ndikojnë në vlerësim, duhet të përcaktojë shtrirjen hapësinore të zonës kritike rezultante.
- Të përcaktohet se fusha rezultante nuk kalon nivelin e referencës sipas legjislacionit.
- Të bëhet paraqitja grafike e zonës kritike në planet xOz për çdo cel dhe kur ka elemente ndërhyrës në drejtimet e tjera të jepen edhe sipas xOy dhe yOz , ose të jepen koordinatat e projeksioneve të pikave ekstreme të zonës kritike.

Eksperti në vlerësimin e tij duhet të marrë në shqyrtim parametrat me të cilët bëhet ekspozimi maksimal, për skenarin më të keq të mundur i cili rezulton në favor të mbrojtjes së publikut.

Nëse ka cele të afërta të kompanive të tjera në distancë më të vogël se 50m nga celet e stacionit në vlerësim, eksperti duhet të marrë në konsideratë zonën kritike rezultante. Në rastin kur nuk është e mundur gjetja e të dhënave të stacioneve të tjera fqinje, eksperti përdor të dhëna në dobi të publikut, duke konsideruar për stacionet bazë fqinje fuqitë maksimale të lejuara për operim nga Autoriteti Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP).

Mosdeklarimi i të dhënave të sakta të stacionit dhe gjeneratorëve të burimeve të rrezatimit jojonizues, që implikojnë fushën e përhapjes së stacionit, mbeten përgjegjësi e personit fizik/juridik.

Në çdo vlerësim për akt miratimi eksperti duhet të provojë me shkrim, se përmasat e zonës kritike rezultante janë të tilla, që nuk prekin zonat publike dhe janë në përputhje me VKM, Nr.743, datë 16.10.2012, Rregullore “Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese”

Për realizimin e raport ekspertizës, referoju faqes zyrtare, <http://www.ishp.gov.al/të-përgjithshme/> ku përcaktohet lista e personave/institucioneve të njohur nga KMR për realizimin e raportit/ekspertizën për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese.

